| 33 | 25_028 | Studimi i fizibilitetit për shfrytëzimin e aseteve të IL-së për prodhim të energjisë alternative-Solare | 20.03.2025 | E hapur Vlerë e Mesme 60,000.00 € | 23.04.2025 | 02.06.2025 | 25,960.00 | **OE: "Energy Service" L.L.C** | **Kontraktuar!** |
| 34 | 25_036 | Furnizim me paijisje UAV për matje gjeodezike dhe pjëset tjera përcjellse | 08.04.2025 | E hapur Vlerë e Mesme 90,000.00 € | 19.05.2025 | / | / | / | **Anuluar**, janë pranuar 4 oferta |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | të papërgji gje! |
| 35 | 25_014 | Furnizim me Fazoneri - RITENDER | 11.04.2025 | E hapur Vlerë e Madhe 150,000.00 € | 30.05.2025 | / | / | / | **Anuluar, asnjë ofertë e pranuar!** |
| 36 | 25_040 | Shqyrtimi i transformatoreve dhe mbrojtjeve për ON dhe SP | 23.04.2025 | Kuotim cmimi 5,000.00 € | 05.05.2025 | 11.06.2025 | 3,115.20 € | **OE: N.T.SH "EL-COM"** | **Kontraktuar!** |
| 37 | 25_039 | Sigurimi i automjeteve të IL-së | 30.04.2025 | E hapur Vlerë e Mesme 11,900.00 € | 29.05.2025 | 19.06.2025 | 9,235.53 € | **OE: K.S. "Dukagjini" SH.A.** | **Kontraktuar!** |
| 38 | 25_043 | Rehabilitimi i objektit-punetorise se Autoparkut, çatia, depoja, objekti i rojes, rregullimi i zyres se punetoreve, ndarja e terminalit, si dhe rregulllimi i zyreve te Arkives | 15.05.2025 | E hapur Vlerë e Mesme 150,000.00 € | 09.06.2025 | | | | **Në proces!** |
| 39 | 25_048 | Furnizimi dhe nderrimi i paisjeve të ndriqimit në Njesine Punuese Ujman | 14.05.2025 | E hapur Vlerë e Mesme 26,000.00 € | 13.06.2025 | 30.06.2025 | 13,946.42 € | **OE "PLUS TRADE" L.L.C.** | **Kontraktuar!** |
| 40 | 25_013 | Riparimi i pompave të Drenazhes në SP Besi dhe SP Bivolak, Rehabilitimi i pompave në SP Samadregje - Ritender | 15.05.2025 | E hapur Vlerë e Mesme 11,000.00 € | 05.06.2025 | 20.06.2025 | 10,985.80 € | **OE "ALY Group" SH.P.K.** | **Kontraktuar!** |
| 41 | 25_050 | OFRIMI I SHËRBIMIT JURIDIK PËR PËRFAQËSIM | 16.05.2025 | E hapur Vlerë e Mesme | 16.06.2025 | | | | **Në proces!** |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | NË GJYKATË KOMERCIALE DHE INSTANCAT TJERA MË TË LARTA | | 100,000.00 € | | | | | |
| 42 | 25-051 | Furnizim me licenca për Microsoft Office 365 për nevojat e N.H. "Iber-Lepenci" Sh.A | 20..05.2025 | E hapur Vlerë e Mesme 48,900.00 € | 11.06.2025 | | | | **Në proces!** |
| 43 | 25_038 | Renovimi i Objektit te Drejtorise-RITENDER | 21.05.2025 | E hapur Vlerë e Madhe 670,000.00 € | 07.07.2025 | | | | **Në proces!** |
| 44 | 25_047 | Furnizimi dhe montimi i turbines se kamionetes FordTranzit - Ritender | 28.05.2025 | Vlere Minimale 950.00 € | 29.05.2025 | 04.06.2025 | 930.01 € | **B.I "Ramadan Raçi"** | **Kontraktuar!** |
| 45 | 25_052 | Furnizimi dhe montimi i pjeseve per Nisan Qashqai dhe Reno Clio | 28.05.2025 | Kuotim çmimi 2,190.00 € | 03.06.2025 | | | | **Anuluar**, asnjë ofertë e pranuar! |
| 46 | 25_035 | Furnizim me Kamioneta | 02.06.2025 | E hapur Vlerë e Madhe 300,000.00 € | 22.07.2025 | | | | **Në proces!** |
| 47 | 25_054 | Furnizimi dhe Montimi i Gomave të Verës | 10.06.2025 | Kuotim çmimi 1,160.00 € | 16.06.2025 | 27.06.2025 | 731.60 € | **OE "HPI" SH.P.K.** | **Kontraktuar!** |
| 48 | 25_037 | Sanimi i gypit të demtuar të çelikut në shtratin e lumit „Ibër – Ritender„ | 13.06.2025 | E hapur Vlerë e Mesme 12,000.00 € | 07.07.2025 | | | | **Në proces!** |
| 49 | 25_056 | Furnizimi dhe montimi i transformatoreve rrymor 35kv 2x200 5 5A në HC | 13.06.2025 | 6,000.00 | 07.07.2025 | | | | **Anuluar**, ofertë e papërgjigjëshme për |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | dhënje kontratë! |
| 50 | 25_052 | Furnizimi dhe montimi i pjesëve për Nisan Qashqai dhe Reno Clio. - RITENDER | 16.06.2025 | 2,190.00 | 24.06.2025 | | | | **Në proces!** |
| 51 | 25_036 | Furnizim me paisje UAV për matje gjeodezike dhe pjesët tjera përcjëllse – RITENDER. | 16.06.2025 | E hapur Vlerë e Mesme 90,000.00 € | 11.07.2025 | | | | **Në proces!** |
| 52 | 25_057 | Furnizimi me pjesë rezervë për mirëmbajtjen e automjeteve dhe makinerive. | 19.06.2025 | E hapur Vlerë e Mesme 18,909.00 € | 16.07.2025 | | | | **Në proces!** |
| 53 | 25_058 | Furnizim dhe servisimin e aparateve për mbrojtje kundër zjarrit | 19.06.2025 | E hapur Vlerë e Mesme 12,000.00 € | 16.07.2025 | | | | **Në proces!** |
| 54 | 25_059 | Furnizim me invertar për zyre | 20.06.2025 | Vlere Minimale 700.00 € | 23.06.2025 | 26.06.2025 | 698.56 | **OE "IBM" SH.P.K.** | **Kontraktuar!** |
| 55 | 25_061 | Furnizim me pajisje të TI per ndërmarrje | 24.06.2025 | E hapur Vlerë e Mesme 54,200.00 € | 18.07.2025 | | | | **Në proces!** |
| 56 | 25_062 | Furnizimi me pompa të ujit për nevoja operative | 26.06.2025 | 6,000.00 | 08.07.2025 | | | | **Në proces!** |
| 57 | 25_014 | Furnizim me fazoneri - RITENDER 2 | 26.06.2025 | 150,000.00 | 13.08.2025 | | | | **Në proces!** |

## ***Departamenti për Planifikim dhe Zhvillim***

Gjatë këtyre muajve ***prill-maj-qershor pra TM2***, 2025 janë realizuar këto aktivitete:

**Kemi pranuar nga arkiva këto raporte për muajt Prill, Maj dhe Qershor 2025, nga menaxherët e kontratave si në vijim:**

- Raporti periodik për kontratën me titull: " **Sigurimi shëndetësor për punëtorët e „Ibër-Lepencit"** me nr. prok.-IL-22-97-2-1-1 nga menaxherja ,05-1106 i datës: 08.04.2025.
- Vendimin për caktimin e menaxherave për kontratën me titull: **"Blerja e mjeteve specifike të punës për DPZH"** IL-25-1679-1-3-6, me nr.protokoli: 02-1113- i datës:10.04.2025.
- Vendimin për caktimin e menaxherave për kontratën me titull: **"Blerja e licensave për programe profesionale AutoCad"** IL-25-759-2-2-1/C212, nr.protokolli: 02:984 i datës:01.04.2025.
- Raporti periodik për kontratën me titull: " **Sigurimi shëndetësor për punëtorët e „Ibër-Lepencit"** me nr. prok.-IL-22-97-2-1-1 nga menaxherja ,05-1575 i datës: 19.05.2025.
- Vendimin per komisionin e vleresimit të tenderit: **"Angazhimi i nje zyreje projektuese për studimin e sanimit të rrëshqitjeve"**, me nr. protokoli:02-1932 te datës 12.06.2025.

**Aktivitetet e tjera gjatë TM2 2025, në kuadër të departamentit tonë kanë qenë:**

- **Mbikëqyrja e punimeve - "Sanimi dhe Renovimi i Objekteve Ndarëse dhe Stacioneve Pompike Besi (Besi, Çagllavicë)"**, me nr. Identifikues: IL-24-4147-5-2-1 dhe nr. Protokoli: 02-2884 të datës 24.07.2024 (vendimi nr. 02-2889 të datës 25.07.2024). Kontrata ka përfunduar, është realizuar pagesa. Raporti përfundimtar: 08-1537 dt. 15.05.2025.
- **Mbikëqyrja e punimeve - "Riparimi i dy segmenteve me nga L=90.0m te kanalit në Babin Most, njeri me profil tërthor A11 dhe tjetri A12"**, me nr. Identifikues: IL-24-8682-5-2-1 dhe nr. Protokoli: 02-3783 të datës 02.10.2024 (vendimi nr. 01-2530 të datës 22.09.2023). Kontrata ka përfunduar. Raporti i punëve të realizuara është përfunduar. Pagesa në proces.
- **Mbikëqyrja e punimeve - "Sanimi i rrëshqitjes së dheut dhe kanalit kryesor Mihaliq-Besi në Babinmost"**, me numër identifikues IL-23-962-5-2-1 dhe nr. Protokoli: 06-757 të datës 07.04.2023 (vendimi nr. 01-2530 të datës 22.09.2023). Kontrata ka përfunduar. Raporti i punëve të realizuara dhe pagesa në proces.
- Projekti ideor: **"Ndërtimi i objektit të rojës dhe hapësirës së magazinës në digën Pridvorica"**. Stafi inxhinierik i shërbimeve të DPZH-së është angazhuar në kontrollimin dhe përmirësimin e projektit të përcjellur nga departamenti Uji dhe Gjenerimi. Projekti ideor është kompletuar me të gjitha fazat përkatëse (përshkrimi teknik, paramasa dhe parallogaria si dhe pjesa grafike) dhe më datë 01.07.2025 është dërguar me email dhe kopje fizike tek drejtori i departamentit Uji dhe Gjenerimi.
- Hartimi i specifikave teknike **"Studimi i fizibilitetit për shfrytëzimin e aseteve të IL-së për prodhim të energjisë alternative-Solare"**.
- **Komisioni për evidentimin dhe klasifikimin e dokumentacionit,** - sipas vendimit nga KE me nr. 02-4779 të dt.23.12.2024, kanë vazhduar angazhimet e komisionit dhe stafit të DPZH-së të caktuar me vendim të drejtorit për evidentimin dhe klasifikimin e dokumentacionit në kuadër të departamentit. Sipas raportit të stafit të dt.13.05.2025 është klasifikuar 100% e dokumentacionit.
- **Komision mbikëqyrës** - mbikëqyrja e kontratës: **"Blerja e mjeteve specifike të punës për DPZH"**, me numër të prokurimit IL-25-1679-1-3-6, Nr.Protokoli 02-1113 me datë 10.04.2025. është pranuar 100% e furnizimit. Kontrata ka përfunduar. Raporti përfundimtar: 08-2246 dt.25.06.2025. Pagesa në proces.

- **Mbikëqyrje e punimeve për kontratën - "Studimi i fizibilitetit për shfrytëzimin e aseteve të IL-së për prodhim të energjisë alternative-Solare"**, me nr. Identifikues: IL-25-2225-2-2-1 dhe nr. Protokoli: 02-1755 të datës 02.06.2025 (vendimi nr. 02-1807 të datës 05.06.2025). Kontrata është në realizim.

- Projekti: **"Renovimi i Stacioneve Pompike: Fushticë, Gjurashin, Korroticë, Krashticë (Gllobar), Pantinë, Samadrexhë dhe rregulimi i banjës dhe kuzhinës në Vushtrri"**. Projekti është përcjellë për kontrollim dhe përmirësim nga departamenti Ujitja. Pas vizitave njoftuese në objektet me stafin inxhinierik të shërbimeve të DPZH-së, ka vazhduar puna në terren për matje dhe evidentim të gjendjes ekzistuese të objekteve përkatëse dhe në zyre nga DPZH.

- **Komision mbikëqyrës** - Mbikëqyrja e kontratës SCADA, projekti me nr. Protokollit 01-1227/1, me vendim të datës 13.06.2019, për nën projektin SCADA. Ndërmarrja jonë, tani e sa kohë është në vlugun e implementimeve të projektit të Bankës Botërore, WSCP-G-ICB-2, dhe këto ditë jemi në fazën e përfundimtare të realizimit të projektit SCADA (përfundimi i projektit është diku fundi i qershorit 2025) që po implementohet përmes kompanisë/konzorciumi: "JV Inter-Adria dhe Oskar.

- **Komision vlerësimi** për tenderin: **"Angazhimin e një zyreje projektuese për sanimin e rrëshqitjeve"**. IL—25-4023-2-2-1, I brendshëm IL-25-002-2-2-1, sipas vendimit nr.02-1932, dt.12.06.2025. Janë zhvilluar punët për vlerësimin e tenderit në fjalë.

- **Komision vlerësimi** për tenderin: **"Studimi i fizibilitetit për shfrytëzimin e aseteve të IL-së për prodhim të energjisë alternative-Solare"**. Komisioni vlerësues ka përfunduar vlerësimin e tenderit në fjalë.

- **Komision vlerësimi** për tenderin: **"Rindërtimi segmenteve të pjesëve të Kanalit Besi-Graçankë"**. Komisioni vlerësues ka përfunduar vlerësimin e tenderit në fjalë.

- **Komision vlerësimi** për tenderin: **"Furnizim me pjesë rezervë për nevoja të NJP Ujman"**.

- **Komision vlerësimi** për tenderin: **"Furnizim me paisje gjeodezike dhe paisje përcjëllse"**. Sipas vendimit nr. 02-1643 dt.26.05.2025. Komisioni vlerësues ka përfunduar vlerësimin e tenderit në fjalë.

- **Komision vlerësimi** për tenderin: **"Rehabilitimi i objektit-punëtorisë se autoparkut, çatia, depoja, objekti i rojës, rregullimi i zyrës së punëtoreve, ndarja e terminalit dhe rregullimi i zyreve se arkivës "**, me nr. të prokurorimit: IL-25-3986-5-2-1, Nr. I brendshëm IL-25-043-521 dhe me nr. të vendimit 02-1901 me datë 11.06.2025. Komisioni vlerësues, ka përfunduar vlerësimin e tenderit.

- **Komision vlerësues** për tenderin: **"Furnizim me pajisje gjeodezike dhe pajisje përcjellëse"**

- **Komision vlerësues** për tenderin: **Furnizimi me paisje UAV per matje gjeodezike dhe paisje tjera** me nr. Identifikues: IL-25-2887-1-2-1 (I brendshem IL-25-036-121) dhe nr. Protokoli: 02-1595 të datës 21-05-2025.

- Pjesëmarrja e stafit të DPZH-së në trajnimin për Sigurinë dhe shëndetit në punë.

- Pjesëmarrja në komisione të ndryshme nga punëtorët e DPZH-së sipas vendimit.

- Hartimi i specifikave teknike te projekteve te mbetura sipas Planit te Prokurimit dhe sipas Planit te Biznesit 2025 ne lidhje me DPZH.

- Përgaditja e raporteve javore/mujor për përformancën e projekteve dhe aktiviteve, duke përfshirë rezultate, sfidat dhe rekomandimet për përmirësim.

## *Departamenti i Shërbimeve të Përbashkëta*

Gjatë këtyre muajve *Prill-Maj-Qershor të vitit 2025* ka nisur përgatitja për inicimin e projekteve të parapara me Planin e biznesit si dhe Planin e prokurimit. Ndër më të rëndësishmet janë: fillimi i pregaditjes për inicimin e projekteve të parapara me Planin e biznesit dhe Planin e prokurimit, angazhimi i përhershëm lidhur me modernizimin e infrastrukturës së IT-së dhe projekti mbi digjitalizimin e proceseve , krijimin e arhivës digjitale brenda ndërmarrjes, ku mes tjerash janë formuar dhe inicuar komisione të veçanta të brendshme mbi analizën e detajuar të dokumentacionit të ndërmarrjes dhe krijimin e raporteve mbi nevojën e asgjësimit të dokumentacionit të vjetërsuar. Në vazhdim ju paraqesim angazhimet sipas zyreve:

**Zyra Ligjore:**

| Nr. | I paditur/debitor | Paditës/kreditor | Kontesti | Rrjedha |
|---|---|---|---|---|
| 1. | Shefqet Aliu dhe Sheremet Aliu | NH "Ibër - Lepenc"Sh.A | Lirim prone | Më datë 08.04.2025, nga Gjykata Themelore në Mitrovicë kemi pranuar ankesën kundër aktgjykimit C.nr.404/2015 të datës 03.03.2025, e ushtruar nga avokati Ragip Kadriu, i cili përfaqëson palët Shefqet dhe Sheremet Aliu. Ndërsa, më datë 16.04.2025, kemi dorëzuar përgjigje në ankesë. |
| 2. | NH "Ibër- Lepenc"Sh.A | Shemsedin Merovci | Kompenzim dëmi | Më datë 08.04.2025, nga Gjykata e Apelit kemi pranuar aktgjykimin Ac.nr.200/22 të datës 19.03.2025, me të cilin refuzohet ankesa e paditësit Shemsedin Merovci, e ushtruar kundër aktgjykimit C.nr.920/21 të datës 22.11.2021. |
| 3. | NH "Ibër -Lepenc"Sh.A | Emin Zejnullahu | Kontest prone | Më 16.04.2025 u mbajt seancë gjyqësore në Gjykatën Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtrri, ku palët paraqitën qëndrimet e tyre.<br>Më 18.04.2025 dorëzuam kërkesë në Komunën e |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | Vushtrrisë për historiatin e pronës 311/4 Z.K Svarcak i Ultë, dhe më 05.05.2025 morëm përgjigje, ndërsa me datën 06.05.2025 përmes një shkrese njoftuam Gjykatën për këtë përgjigje. Më datën 11.06.2025 është mbajtur seanca përfundimtare. |
| 4. | Xhemajl Fazlia | NH "Ibër-Lepenc"Sh.A | Lirim prone | Më datë 23.04.2025, në Gjykatën Themelore në Prishtinë është mbajtur seanca gjyqësore gjatë së cilës është caktuar eksperti i gjeodezisë, i cili do të hartojë ekspertizën gjeodezike për çështjen në fjalë.<br>Seanca e radhës është caktuar të mbahet më datë 10.07.2025 dhe do të zhvillohet në vendshikim, për verifikimin e gjendjes faktike në terren. |
| 5. | Afrim Sadiku | NH "Ibër - Lepenc"Sh.A | Lirim prone | Më datën 23.04.2025, në Gjykatën Themelore në Mitrovicë është mbajtur seanca gjyqësore, ku i pranishëm ka qenë edhe eksperti i gjeodezisë. Gjatë kësaj seance, eksperti ka paraqitur ekspertizën gjeodezike të hartuar në lidhje me çështjen në shqyrtim.<br>Lidhur me seancën e radhës, palët do të njoftohen nga gjykata përmes ftesës së rregullt |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 6. | NH "Ibër Lepenc"Sh.A | Goran Kasalovic | Kontest Pune | **Më datën 05.05.2025**, kemi pranuar **Aktvendimin nr. 05-1404**, të datës **05.05.2025**, lidhur me lëndën me numër **C.nr. 23/2025**,me të cilin **konsiderohet e tërhequr padia e paditësit Goran Kasalovic nga Mitrovica.** |
| 7. | Bahri Seferi | NH "Ibër - Lepenc"Sh.A | Lirim prone | **Më datën 12.05.2025**, nga **Gjykata Themelore në Mitrovicë**, kemi pranuar **Aktvendimin nr. 05-1487**, me të cilin **propozimi për zgjerimin e padisë kthehet për plotësim**, duke kërkuar **sigurimin e adresave të të padituve të tjerë.**<br><br>**Më datën 14.05.2025**, në të njëjtën gjykatë, kemi dorëzuar **plotësimin e padisë nr. 02-1520** dhe **jemi në pritje të ftesës për seancën e radhës.** |
| 8. | Branislav Nidiq<br>NH "Ibër -Lepenc"Sh.A<br>Ndermarrja Publike Banesore | Hamdi Zenelaj | Vërtetim i të Drejtës së Pronës | Më datë 15.05.2025, nga Gjykata e Apelit të Kosovës në Prishtinë, kemi pranuar Aktgjykimin Ac.nr. 6433/2022, me të cilin është refuzuar ankesa e të paditurit Bratislav Nidiq, duke vërtetuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore, C.nr. 1746/19, të datës 20.06.2022. |
| 9. | Naim Leci | NH "Ibër - Lepenc"Sh.A | Lirim prone | **Më datë 19.05.2025**, është mbajtur **seanca në terren**, ku ishin të pranishëm **palët dhe eksperti i gjeodezisë.** Eksperti, pas matjeve në terren, do të hartojë **ekspertizën gjeodezike. Për seancën e radhës do të ftohemi nga Gjykata me ftesë të rregullt**, pas pranimit të **ekspertizës gjeodezike.** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 10 | NH "Ibër -Lepenc"Sh.A | Mysefe Terziqi, Kader Terziqi, Qazim Terziqi, Sebahate Terziqi, Remzije Ramaxhiku, Afize Gunga dhe Minavere Sejdiu | Vertetim Pronësie | Me datën 13.06.2025 nga Gjykata themelore në Mitrovicë kemi pranuar padinë me nr 05-1943 të ushtruar nga Mysefe Terziqi, Kader Terziqi, Qazim Terziqi, Sebahate Terziqi, Remzije Ramaxhiku, Afize Gunga dhe Minavere Sejdiu në emer të ndërmarrjes D.S Hidrotekniqki, ndërsa me datën 27.06.2025 kemi dorëzuar përgjigjen në padi me nr.02-2446. |
| 11 | NH "Ibër- Lepenc"Sh.A | Hamit Osmani | Kontest Prone | Më datë 17.06.2025, në Gjykatën Themelore në Prishtinë, është mbajtur seanca përfundimtare në lidhje me çështjen gjyqësore përkatëse. Aktualisht jemi në pritje të aktgjykimit. |
| 12 | Persona të pa njohur | NH "Ibër - Lepenc"Sh.A | Lirim prone | Me datë 26.06.2025, pranë Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, kemi dorëzuar Kallëzim Penal lidhur me uzurpimin e paligjshëm të pronave në Komunën e Zubin Potokut, konkretisht në zonën kadastrale Rezalë. Kallëzimi është bërë ndaj personave të panjohur që dyshohet se kanë ndërmarrë veprime të kundërligjshme duke shfrytëzuar apo uzurpuar pronat që nuk janë në pronësi të tyre legjitime. |

**Zyra e Burimeve Njerëzore:**

Zbatimi i procedurave rekrutuese në Konkursin e Brendshëm për pozitat:

1. Zyrtar Operimit - (Numri i kryerësve 1);
2. Zyrtar për Paga - (Numri i kryerësve 1);
3. Zyrtar për Faturim - (Numri i kryerësve 1);
4. Zyrtar i Arkivës - (Numri i kryerësve 1);

5. Punëtor i Sigurimit Fizik - (Numri i kryerësve 1);
6. Punëtor në Njësinë e mirëmbajtës së infrastrukturës - (Numri i kryerësve 1);
7. Punëtor në mirëmbajtjen e rrjetit të sistemit në NJ.P "Shkabaj" – (Numri i kryerësve 1);
8. Punëtor për mirëmbajtjen e objekteve dhe punë tjera ndihmese në kuadër te NJ.P." Komoran" - (Numri i kryerësve 1).

***Punë dhe angazhime të tjera nga BNJ:***

- Përgatitja e vërtetimeve lidhur me përvojën e punës në NPH "Ibër -Lepenc" ,
- Njoftimi i punëtorëve të Ndërmarrjes lidhur me mundësinë e sigurimit shëndetësor për familjaret e tyre,
- Me kërkesën e Sekretarit të Ndërmarrjes është përgatitur raporti i hyrje-daljeve të punëtorëve për datën: 13.06.2025 dhe i njëjti u është dërguar K.E. Sekretarit dhe gjithë menaxhmentit,
- Përmbyllja e dosjes së punëtorit të pensionuar .
- Përgatitja e raportit lidhur me përmbylljen e procesit rekrutues për pozitat e shpallura në konkursin publik për punëtor sezonal dhe për pozitat e shpallura në konkursin e brendshëm, raport ky i dërguar në Ministri.
- Përgatitja e raportit lidhur me përmbylljen e procesit rekrutues për pozitat e shpallura në konkursin e brendshëm dhe për pozitat e shpallura në konkursin e brendshëm, raport ky i dërguar në Ministri.
- Përgatitja e raportit mujore të sigurimit shëndetësor.

## *Njësia zbatuese e projektit WSCP*

Aktivitetet në kuadër Projektit të Bankës Botërore të zhvilluara gjatë tremujorit të dytë (TM2) janë pasqyruar si në vazhdim :

NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE "IBËR - LEPENC" SH.A.
HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE "IBËR - LEPENC" J.S.C.
VODOPRIVREDNO PREDUZEĆE "IBËR - LEPENC" D.D.

| | |
|---|---|
| **Projekti me Bankën Botërore** | |
| **RAPORTI TREMUJOR (TM2_2025)** | |
| **Emri i Kontratës:** | **Siguria e Ujit dhe Mbrojtja e Kanalit - WSCP** |
| **Investitori** | **N.H. "Ibër Lepenc" sh.a Prishtinë** |
| **Nën-projektet** | **1.Rehabilitimi i kanalit kryesor të Ibër Lepencit**<br>**2.Konsulenca**<br>**3.SCADA** |
| | |
| | |
| **1. Emri i Projektit** | **Rehabilitimi i kanalit kryesor të Ibër Lepencit** |
| **Kontraktori** | **"Famis.CO and Kit AK Gradnje"** |
| **Data e firmosjes së kontratës** | **24/05/2023** |
| **Çmimi i Kontratës:** | **12,875,191.63 €** |
| | |
| **2. Emri i Projektit** | **Konsulenca – Mbikqyrja e punimeve gjatë realizimit të punimeve në kanalin kryesor** |
| **Kontraktori** | **"IPE Proing sh.p.k"** |
| **Data e firmosjes së kontratës** | **08/06/2019** |
| **Çmimi i Kontratës:** | **270,700.00 €** |
| | |
| **3. Emri i Projektit** | **Furnizimi dhe montimi i sistemit SCADA** |
| **Kontraktori:** | **JV Interadira & OSKAR-EL** |
| **Data e firmosjes së kontratës** | **21/05/2019** |
| **Çmimi i Kontratës:** | **1,072,044.24 €** |
| **Vlera e punimeve të kryera:** | **899,923.20 €** |

**Periudha Raportuese: 01.04.2025 - 31.06.2025**

**Aktivitetet e punës dhe raportimi i tyre**

**Punimet e rehabilitimit dhe riparimit përfshijnë si më poshtë:**

1. Rindërtimi i pjesëve të hapura të të kanalit trapezoid dhe drejtkëndësh me Beton (gjatësia totale përafërsisht 9,194.70 m në gjithsej 55 seksione, në komunat: Zubin Potok, Mitrovicë, Vushtrri, dhe Obiliq), duke ruajtur rrjedhën e panderprerë të Ujit.
2. Zëvendësimi i kanalit të hapur pranë fshatit Zubin Potok me elemente nga betoni dhe mbulesë të kanalit (gjatësia përafërsisht 400 m).
3. Ndërtimi i sektorit të dytë 2 të Rezervuarit Bufer me gjatësi 800 m dhe gjerësi 8m' .
4. Riparimi i Akuadukteve me gjatësi 24600.23m2, riparimi Ii sipërfaqes së brendshme të akuadukteve duke riparuar vrimat dhe aplikimin e materialit hidroizolues si shtresë e sipërme duke përfshirë trajtimin e fugave sipas Specifikimit Teknik dhe kërkesave të furnizuesit.
Numri i akuadukteve është 17 copë me gjatësi totale përafërsisht. 1,989,264.01m në komunat Zubin Potok 7, Mitrovicë 2 dhe Vushtrri 8.
5. Punime të tjera
Ndërtimi i murit mbrojtës 318 m'
Pastrimi dhe rivendosja e 41 lëshesave ekzistuese dhe ndërtimi i 10 kanaleve të reja
Ndërtimi i 21 kutive të shpërndarjes së ujit (dhoma betoni nëntokësore direkt në buzë të kanalit me marrjen e ujit nga kanali)
Instalimi i 13 rrjetave metalike në kalimine kanalit nga seksionet e kanalit të hapur në atë nëntokësor.
Punimi i gropave septike (pellgje betoni nëntokësor, 4 x 8,000L), për lidhje me shtëpitë afër kanalit.
6. Çështjet mjedisore
Ekzekutimi i punimeve të riparimit dhe rehabilitimit duhet të jetë në përputhje me Kornizën e Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social (ESIAF), Kornizën e Menaxhimit Mjedisor dhe Social (ESMF), Kornizën e Politikave të Zhvendosjes (KPZH), politikat dhe procedurat e Bankës Botërore, si dhe legjislacioni.

- Kontraktori "JV Famis Co dhe Kit AK Gradnje"
  Vazhdimi i punimeve në kanalin kryesor

Pas nënshkrimit të kontratës me datën 24.05.2023, kontraktori "Famis Co dhe Kit AK Gradnje" kanë paraqitur Planin Dinamik të mobilizimit në teren dhe kanë filluar punët sipas kushteve të kontratës FIDIC, ku bazohet projekti "Rehabilitimi i kanalit kryesor të Ibër Lepencit".
Gjatë kësaj periudhe të raportimit kontraktori ka punuar me disa pozicione të punimeve:

**Kanali Trapezoidal**

Në segmentin A3.6 nga Km 27+138.37 deri në Km 27+591.20, me gjatësi L = 452.83 m, kontraktori ka përfunduar rreth 150 m, ose 33% të segmentit.
Në segmentin A4.2 nga Km 29+725.46 deri në Km 31+190.89, me gjatësi L = 1,465.43 m, kontraktori ka përfunduar rreth 1,000 m, ose 68% të segmentit.
Kontraktori ka përfunduar 4 segmente, ndërsa 2 segmente të tjera kanë përparuar si më poshtë: Deri më tani, Kontraktori ka bërë përparim në segmentet e mëposhtme:

| Nr | Segment No. | from | Up to | Length | Progress |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | A2.1 | Km 16+540.00 | Km 16+864.27 | L= 324.27m | 100.00% |
| 2 | A3.2 | Km 22+340.00 | Km 23+142.70 | L=802.70m | 0.00% |
| 3 | A3.6 | Km 27+138.37 | Km 27+591.20 | L=452.83m | 33.00% Bypass installed |
| 4 | A4.2 | Km 29+725.46 | Km 31+190.89 | L=1,465.43m | 68.00% 1,000m' finished |
| 5 | A6.1 | Km 36+147.52 | Km 36+517.89 | L= 370.37m | 0.00% |
| 6 | A6.2 | Km 36+631.37 | Km 36+733 | L= 101.20m | 100.00% |
| 7 | A7.2 | Km 42+266.03 | Km 42+527.60 | L=261.57m | 100.00% |
| 8 | A7.4 | Km 45+704.08 | Km 46+405.13 | L=701.05m | 100.00% |
| | | | Total: | 4,478.98 m | 69.35% cost based 2,534.08 m' completed 64.56% length completed |

Deri më tani, Kontraktori ka përfunduar 2,534.08 m nga gjithsej 4,478.98 m të kanalit trapezoidal, ose 64.56% të gjatësisë së tij.

**Rehabilitimi i Akuadukteve**

Kontraktori ka përfunduar rehabilitimin e 16 segmenteve të akueduktеve. Duke arritur një progres prej afërsisht 96.42% në rehabilitimin e tyre ose duke përfunduar 2,053.70 metra nga gjithsej 2,129.89 metra.

**Kanalet**

| No. | PAK | from | Up to | Length | Progress |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | PAK1.1 | Km 04+305.01 | Km 04+369.35 | L=64.34 m' | 100.00% |
| 2 | PAK1.2 | Km 05+054.00 | Km 05+126.55 | L=72.55 m' | 100.00% |
| 3 | PAK1.3 | Km 07+529.57 | Km 07+586.89 | L=57.32 m' | 100.00% |
| 4 | PAK1.4 | Km 08+542.73 | Km 08+620.00 | L=77.27 m' | 100.00% |
| 5 | PAK1.5 | Km 09+170.86 | Km 09+344.39 | L=173.53 m' | 100.00% |
| 6 | PAK1.6 | Km 09+738.08 | Km 09+817.92 | L=79.84 m' | 100.00% |
| 7 | PAK1.7 | Km 11+078.87 | Km 11+114.64 | L=35.77 m' | 0.00% |
| 8 | PAK1.8 | Km 12+497.55 | Km 12+497.55 | L=162.45 m' | 100.00% |
| 9 | PAK2.1 | Km 19+632.40 | Km 19+799.26 | L=166.86 m' | 100.00% |
| 10 | PAK2.2 | Km 20+085.68 | Km 20+417.58 | L=331.90 m' | 100.00% |
| 11 | PAK2.3 | Km 23+894.68 | Km 24+033.93 | L=139.25 m' | 100.00% |
| 12 | PAK2.4 | Km 24+894.78 | Km 25+080.39 | L=185.61 m' | 100.00% |
| 13 | PAK2.5 | Km 26+111.90 | Km 26+188.67 | L=76.77 m' | 100.00% |
| 14 | PAK2.6 | Km 27+011.97 | Km 27+138.37 | L=126.40 m' | 100.00% |
| 15 | PAK3.3 | Km 34+934.73 | Km 34+975.15 | L=40.42 m' | 0.00% |
| 16 | PAK3.5 | Km 36+517.87 | Km 36+631.37 | L=113.50 m' | 100.00% |
| 17 | PAK4.1 | Km 42+635.09 | Km 42+760.74 | L=125.65 m' | 100.00% |
| 18 | E2A.1 | Km 45+603.62 | Km 45+704.08 | L=100.46 m' | 100.00% |
| | | | Total: | L=2,129.89 m' | 96.42% |

**drejtkëndëshe**

Kontraktori ka vazhduar me devijimin e rrjedhës së ujit përmes kanalit anësor, në Segmentin B10A.15 nga Km 47+280.00 deri në Km 47+364.47, dhe ka vazhduar me segmente të tjera për kanalin e tipit drejtkëndësh.

| Nr | Segment No. | from | Up to | Length | Progress |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | B10A.15 | Km 47+280.00 | Km 47+364.47 | L=84.47m | 100% |
| 2 | B10A.16 | Km 47+551.50 | Km 47+620.00 | L=68.50m | 100% |
| 3 | B10A.17 | Km 47+738.54 | Km 47+869.05 | L=130.51m | 100% |
| 4 | B10A.18 | Km 48+113.12 | Km 48+378.81 | L=265.69m | 100% |
| 5 | B10A.19 | Km 48+428.80 | Km 48+496.00 | L=67.20m | 100% |
| 6 | B10A.19' | Km 48+604.75 | Km 48+684.59 | L=79.84m | 100% |
| 7 | B10A.20 | Km 48+854.91 | Km 49+191.00 | L=336.09m | 94% |
| | | | Total: | 1,032.30 | 96.74% |

Deri më tani, Kontraktori ka përfunduar 998.69 metra nga gjithsej 1,032.30 metra, ose 96.74%.

**Seksioni i kanalit drejtkëndësh i mbyllur – L = 405.38m**

Ky segment ndodhet në qytetin e Zubin Potokut dhe, si i tillë, qasja në kantier është e kufizuar sidmos pas ngjarjeve me rastin e demtimit të Aquadtit në Varage, Veri. Progresi i punimeve në këtë segment është rreth 5% deri më tani.

**Rehabilitimi i kanalit në perqindje (%)**

| Bill No. A2 - Canal Rehabilitation | length | segments | Progress | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | m' | pcs. | length | number | percentage |
| Canal section for trapezoidal canal type | 4,479.42 | 8 | 2,534.08 m | 4 (2 ongoing) | 56.57% |
| Canal section for rectangular open type | 1,032.30 | 7 | 998.69 m | 6.90 | 96.74% |
| Canal section rectangular closed | 405.38 | 1 | 0.00 m | 0.00 | 0.00% |
| Rehabilitation of Aqueduct | 2,129.89 | 18 | 2,053.70 m | 16.00 | 96.42% |

**Puseta BA për SCADA**

Kontraktori është në përfundim të ndërtimit të pusetës për sistemin Scada tek përfundimi i kanalit afër Kosova – B. Ka mbetur vetëm instalimi i Ujëmatsave dhe përfundimi i punëve të izolimit.

**Ecuria e punimeve në krahasim me kontratën kumulative.**







**Më poshtë janë paraqitur disa foto të punimeve në terren:**









